



BIO

Fatjona Qurku, është diplomuar në Universitetin e Bukureshtit, Fakultetin e Shkencave Politike, në vitin 2007, për Shkenca Politike. Në vitin 2009 ka marrë gradën Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Politika Publike nga Shkolla Kombëtare e Studimeve Politike dhe Administrative, në Bukuresht.

Gjatë periudhës së studimit është angazhuar në projekte rinore me bazë sistemet e qeverisjes dhe pjesëmarrjen. Që prej vitit 2010, është e angazhuar si pedagoge në Universitetin "Barleti", në Departamentin e Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit ku aktualisht mban detyrën e përgjegjëses për zhvillimin e kurrikulës.

Gjithashtu ajo ka qenë e angazhuar si drejtuese e Zyrës së Pranimeve dhe Zyrës Alumni dhe Karriera gjatë periudhës 2010 - 2015. Fatjona Qurku ka një pjesëmarrje të shquar në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare me fokus sistemet e qeverisje, demokratizimin, partitë politike, etj, dhe një përvojë të gjatë në mësimdhënie në lëndët: "Hyrje në Shkenca Politike", "Qeverisje e Krahasuar", "Historia e Institucioneve", "Partitë Politike", etj.

FATJONA QURKU

MSC

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

MSC. Fatjona Qurku është
Përgjegjëse për Zhvillimin e Kurrikulës

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Shkenca Politike, Politologji

EMAIL

f.qurku@umb.edu.al